



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ZYRËS SË RREGULLATORIT TË ENERGJISË PËR VITIN 2025

Prishtinë, maj 2026

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

A1 Nga testimet e realizuara kemi identifikuar nënvlerësim të pasurisë kapitale në shumën prej 74,639€, si rezultat i mosregjistrimit të plotë dhe me kohë të pasurive në SIMFK para përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare, dhe mbivlerësim në shumë prej 2,576€ në regjistrin e pasurive nën 1,000€ si rezultat i gabimeve në kalkulimin e zhvlerësimit të pasurive.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Zyrës së Rregullatorit të Energjisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A2 Mos ndërmarrje e veprimeve të nevojshme për inkasimin e këstit të fundit të gjobës prej 2,118,750€.
- A3 Faturimi i shërbimeve të ngrohjes dhe ftohjes me çmim fiks 1.02 €/m<sup>2</sup> (1,056€ në muaj) pa dokumentacion mbështetës që tregon bazën e llogaritjes.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryesuesi i Bordit i Zyrës së Rregullatorit për Energji është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryesuesi i Bordit i Zyrës së Rregullatorit për Energji është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë pëmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesuesi i Bordit i Zyrës së Rregullatorit për Energji është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë më shumë fokus për shkak të ndikimit janë mbajtja e regjistrave dhe menaxhimi i pasurive, si dhe nga aspekti i pajtueshmërisë ligjore kërkohej veprime konkrete dhe në kohë për inkasimin e borxhit nga gjambat dhe dokumentimin e bazës së kalkulimit të shërbimeve të ngrohjes dhe ftohjes.

Rekomandimet e dhëna kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me (7) shtatë rekomandime të reja.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja A1 - Mangësi në mbajtjen e regjistrave të pasurisë

##### Gjetja

Sipas nenit 6 të Rregullores MF-Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, organizatat buxhetore janë të obliguara të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi për të gjitha informatat financiare dhe jofinanciare. Po ashtu, sipas nenit 6 paragrafi 3 të Rregullores MF-Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”.

Më tutje sipas nenit 22 i Rregullorës nr.02/2013, Zhvlerësimi i pasurisë jo financiare pika 1. Zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtëvizore. Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë dhe pika 2. Zhvlerësimi llogaritet në baza mujore, pasuria nuk zhvlerësohet për muajin e blerjes.

Kemi identifikuar se vlera e pasurisë kapitale e paraqitur në Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) ishte e nënvlerësuar për vlerën neto në libra 74,639€ (pas aplikimit të zhvlerësimit). Kjo për shkak se një veturë në vlerë të blerjes prej 38,950€, e pranuar më 25.02.2025, si dhe pajisje të TI-së në vlerë të blerjes prej 41,478€ të pranuar më 27.11.2025, nuk ishin të regjistruara në regjistrin kontabël të SIMFK-së në kohën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

Po ashtu, pasuritë nën 1,000€ të blera gjatë vitit në vlerë 27,843€ (të cilat sipas dokumentacionit janë blerë dhe pranuar në periudhën mars-gusht 2025), janë regjistruar në sistem vetëm në muajin nëntor 2025 duke regjistruar këtë si datë të pranimit, pavarësisht se ato janë blerë dhe pranuar në periudha të ndryshme gjatë vitit. Si rezultat, zhvlerësimi për këto

pasuri është llogaritur vetëm për muajin dhjetor 2025, në vend që të llogaritej në baza mujore sipas periudhës përkatëse, siç kërkohet me rregullore. Për pasojë, regjistri i pasurive nën 1,000€ është mbivlerësuar për mos aplikimin e drejtë të zhvlerësimit për këto pasuri në shumën prej 2,576€.

Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i gabimit në regjistrimin e pasurisë nga zyrtarët përgjegjës, si dhe mungesës së verifikimit të plotë të statusit të artikujve në SIMFK dhe në regjistrat kontabël para përgatitjes së pasqyrave financiare. Si rrjedhojë, pavarësisht përpjekjeve për korrigjim dhe komunikimit me zyrtarët e SIMFK-së, ndryshimet nuk janë reflektuar plotësisht dhe me kohë në regjistrat zyrtarë, duke rezultuar në paraqitje jo të saktë të pasurisë në Pasqyrat Vjetore Financiare, si dhe për shkak të mbingarkesës me punë, dhe mungesës së njohurive të mjaftueshme për përdorimin e sistemit e-Pasuria.

**Ndikimi** Mangësit në mbajtjen e regjistrave kanë ndikuar në paraqitje jo të plotë dhe të drejtë të pasurive të organizatës në Pasqyrat Financiare Vjetore. Kjo tregon dobësi në funksionimin e kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, duke cenuar besueshmërinë e evidencave kontabël.

**Rekomandimi A1** Kryetari i Bordit të ZRRE-së duhet të sigurojë që janë vendosur kontrollet e duhura lidhur me regjistrimin e pasurive, në mënyrë që të gjitha pasuritë e ZRRE-së të regjistrohen në regjistrat përkatës dhe në kohë. Po ashtu, duhet të sigurohet që regjistrat kontabël të pasurive të azhurnohen para përgatitjes së pasqyrave financiare, me qëllim që raportimi i tyre të jetë i drejtë dhe i saktë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A2 - Mungesa e veprimeve të mjaftueshme për realizimin e arkëtimit të gjobës

#### Gjetja

Sipas nenit 57 paragrafi 8 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, në rast të mospagesës së dënimit të shqiptuar nga Rregullatori, Zyra e Rregullatorit për Energji obligohet që të iniciojë procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente për realizimin e pagesës së gjobës.

Një detyrim i tillë parashihet edhe në Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat të nxjerrë nga Rregullatori, sipas së cilës, në rast të mospagesës së gjobës brenda afatit të përcaktuar ligjor, sipas nenit 9 paragrafi 7, Rregullatori me padi duhet të iniciojë procedurën gjyqësore në gjykatën kompetente, ndërsa paragrafi 12 parasheh se Rregullatori fillon procedurën gjyqësore për realizimin e pagesës së saj si borxh civil.

Po ashtu, sipas nenit 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative, padia e paraqitur kundër një akti administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e tij, përveç në rastet kur organi kompetent vendos ndryshe dhe kur plotësohen kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit.

Me datë 16 nëntor 2022, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka marrë vendim për shqiptimin e gjobës ndaj kompanisë KESCO në shumën prej 8,475,000€, për shkak të shkeljeve ligjore të konstatuara në lidhje me blerjen e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet. Sipas këtij vendimi, gjopa duhej të paguhej brenda një periudhe dy vjeçare, respektivisht deri më 15 nëntor 2024, në katër këste të barabarta. KESCO ka paraqitur padi për anulimin e këtij vendimi dhe ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të tij. Megjithatë, kërkesat janë refuzuar nga Gjykata Komerciale në shkallë të parë dhe të dytë, si dhe Gjykata Supreme e Kosovës e cila ka refuzuar kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit.

Sipas evidencave të pagesave, KESCO deri më tani ka realizuar pagesën e tre kësteve të gjobës, përkatësisht:

kësti i parë më 22.09.2023,

kësti i dytë më 15.01.2024,

kësti i tretë më 17.10.2024.

Megjithatë, kësti i katërt në shumën prej 2,118,750€ nuk është paguar ende, edhe pse afati përfundimtar për përmbushjen e obligimit ka qenë 15 nëntor 2024. Nga dokumentacioni i shqyrtuar gjatë auditimit është konstatuar se deri në shkurt 2026 obligimi për pagesën e kështit të fundit ende nuk ishte përmbushur, duke mbetur si llogari të arkëtueshme për ZRRE-në.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosndërmarrjes në kohë të veprimeve të nevojshme ligjore nga ZRRE për realizimin e plotë të pagesës së gjobës pas skadimit të afatit të përcaktuar me vendim.

**Ndikimi** Mosrealizimi i plotë i pagesës së gjobës dhe mosndërmarrja me kohë e veprimeve për arkëtimin e saj rrit rrezikun e mosinkasimit të shumës prej 2,118,750€, krijon precedent për moszbatim të vendimeve të rregullatorit dhe mund të çojë në humbjen e të drejtës për ekzekutimin e aktit administrativ, duke rrezikuar humbjen e të hyrave për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

**Rekomandimi A2** Bordi i ZRRE-së duhet të sigurojë që të ndërmerren në kohë veprimet e nevojshme ligjore për inkasimin e plotë të gjobave të shqipëtuara.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

### **Çështja A3 - Dobësi në pagesën e shërbimeve për ngrohje/ftohje**

**Gjetja** Sipas nenit 9 pika 3 të kontratës mbi qiranë nr.048/24 të lidhur në janar të vitit 2024, ZRRE, obligohet që për shërbimet e ngrohjes/ftohjes të lidhë një kontratë të veçantë në të cilën duhet të përcaktohen kushtet dhe çmimet e shërbimit. Në vijim të kësaj, në janar të vitit 2025 është lidhur marrëveshje e veçantë ndërmjet ZRRE-së dhe operatorit ekonomik ofrues të shërbimeve. Sipas nenit 8, pikat 2.1 dhe 2.2 të kësaj marrëveshjeje, shpenzimet për ngrohje/ftohje për sipërfaqen prej 880 m<sup>2</sup>, për sezonin dimëror (15 tetor - 15 prill) dhe sezonin veror (16 prill - 14 tetor), duhet të paraqiten me dëshmi pas matjes dhe të llogariten proporcionalisht me sipërfaqen që ngrohet/ftohet.

Pagesat për shërbimet e ngrohjes dhe ftohjes janë realizuar pa u shoqëruar me dëshmi apo matje tjera që arsyetojnë mënyrën e llogaritjes së çmimit të shërbimit. Marrëveshja e veçantë për këto shërbime nuk përcakton çmim të saktë për m<sup>2</sup>, ndërsa faturimi është bërë me çmim fiks prej 1.02 €/m<sup>2</sup> (për sipërfaqen 880 m<sup>2</sup> rezulton të jetë 1,056€ në muaj). Për më tepër, nuk janë ofruar dëshmi që tregojnë metodën e përdorur nga operatori ekonomik për përcaktimin e këtij çmimi, përfshirë nëse ai është bazuar në shpenzimet reale të energjisë apo në ndonjë metodë tjetër të ndarjes proporcionale në raport me njësitë e tjera të ndërtesës. Në dhjetor 2025 ZRRE kishte nënshkruar marrëveshjen e re për vitin 2026 ku kishte përfshirë çmimin për shërbimin, e cila do të vlerësohet në auditimin e vitit pasues.

Shkaku i kësaj situatë ndikohet nga mungesa e rregullimit të qartë në marrëveshje dhe e një mekanizmi të kontrollit për të verifikuar mënyrën e llogaritjes së çmimit të shërbimeve të ngrohjes dhe ftohjes, dhe mungesa e procedurave të dokumentuara për verifikimin e bazës së faturimit para realizimit të pagesave.

**Ndikimi** Mungesa e dëshmive mbështetëse ndikon në rritjen e rrezikut që pagesat të mos bazohen në kosto reale, duke rezultuar në pagesa potencialisht jo të arsyetuara.

**Rekomandimi A3** Kryetari i Bordit të ZRRE-së duhet të sigurojë se janë vendosur mekanizma të efektiv të kontrollit për verifikimin e bazës së faturimit dhe dokumentacionit mbështetës para realizimit të pagesave.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe meditje është 387,597€. Realizimi për këtë kategori ishte 100%.

#### Çështja A4 - Mosazhurnimi i rregulloreve të brendshme dhe kontratave të punës në përputhje me ndryshimet ligjore

##### Gjetja

Sipas nenit 28 paragrafi 4 të Ligjit 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, institucionet publike dhe agjencitë rregullatorë janë të obliguara që organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës ta rregullojnë përmes miratimit të rregulloreve nga drejtori apo organi kolegjal i agjencisë, pas mendimit paraprak të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ministrit përgjegjës për financat. Po ashtu, aktet individuale të zyrtarëve duhet të klasifikohen në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 38 që rregullon klasifikimin e pozitave në shërbimin civil, si dhe me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nenin 14 paragrafi 3, i cili përcakton se klasifikimi i pozitave të punës është bazë për përcaktimin e pagës në sektorin publik.

ZRRE nuk kishte azhurnuar rregulloren e brendshme për përshkrimin e vendeve të punës dhe sistematizimin në përputhje me legjislacionin në fuqi. Mungesa e kësaj rregulloreje dhe harmonizimit me ndryshimet në kornizën ligjore ka ndikuar që edhe kontratat individuale të mos reflektojnë plotësisht kërkesat ligjore dhe strukturën organizative. Kontratat e punës nuk ishin azhurnuar në përputhje me kërkesat e reja ligjore, përfshirë harmonizimin me sistemin e ri të koeficientëve dhe formatin e ri të akteve të emërimit.

Po ashtu, në një rast kemi vërejtur mospërputhje në ekuivalencën ndërmjet sistemit të vjetër dhe sistemit të ri të klasifikimit të koeficienteve për qëllim të llogaritjes së pagës bazë. Aktualisht pozita "Drejtues/e i/e Ulët - I9", me koeficient 7.4 klasifikohet dhe paguhet si "Profesional 1 - I12", me koeficient 5.75, çka rezulton në një pagë bazë më të ulët krahasuar me ekuivalencën e përcaktuar sipas Vendimit të Qeverisë për ekuivalentim.

Sipas shpjegimeve të menaxhmentit, procesi i azhurnimit është në zhvillim, megjithatë deri sa ishim në proces të auditimit nuk na kanë ofruar ndonjë dëshmi se ishin ndërmarrë veprime konkrete për finalizimin e procesit të azhurnimit, pavarësisht ndryshimeve ligjore.

##### Ndikimi

Mosazhurnimi i rregulloreve të brendshme dhe kontratave të punës rrit rrezikun për sigurinë juridike në marrëdhëniet e punës dhe mospasqyrim të qartë të pozitave në strukturën e pagave dhe koeficientëve.

##### Rekomandimi A4

Kryetari i Bordit të ZRRE-së duhet të prioritetizoj finalizimin e azhurnimit dhe miratimit të rregulloreve për organizim të brendshëm dhe asaj për klasifikimin e vendeve të punës. Të harmonizohen kontratat apo aktet e reja të emërimit me strukturën e re të pagave dhe koeficienteve në përputhje me kërkesat ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

## 2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar është i njëjti 80,800€, ndërsa realizimi ishte 80,428€, apo 99.54%.

### Çështja A5 - Mos përdorimi i modulit në sistemin e prokurimit elektronik për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve

**Gjetja** Sipas Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.2, vlerësimi i performancës së kontraktuesve duhet të bëhet përmes sistemit të prokurimit elektronik, përmes modulit përkatës nga menaxherët e kontratës, gjatë dhe pas përfundimit të implementimit të kontratave publike. Gjithashtu, neni 70.24.f përcakton se menaxheri i kontratës është përgjegjës për përgatitjen, mbajtjen dhe arkivimin e të gjithë regjistrave të menaxhimit të kontratës në këtë modul.

Në tre (3) kontrata <sup>1</sup> sipas procedurave të zhvilluara në vitin aktual është konstatuar se menaxherët e kontratave nuk kanë përdorur modulin për menaxhimin dhe vlerësimin e performancës në sistemin e prokurimit elektronik, siç kërkohet me rregullore.

Edhe pse IKAP dhe KRPP kanë ofruar trajnime përkatëse, menaxherët e kontrata dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të tyre, nuk kanë ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre ligjore lidhur me menaxhimin e kontratave.

**Ndikimi** Mungesa e vlerësimit të performancës së kontratës përmes sistemit të prokurimit elektronik, ndikon në menaxhimin jo efektiv dhe transparent të kontratave, si dhe nuk ofron mundësi që menaxhmenti në kohë reale të merr informata mbi performancën dhe realizimin e kontratës.

**Rekomandimi A5** Kryetari i Bordit të ZRRE-së duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave të përmbushin përgjegjësitë ligjore për menaxhimin e kontratave të prokurimit, duke siguruar monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të kontratave nëpërmjet modulit për menaxhim të kontratave në sistemin e prokurimit elektronik.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 54,799€, pasurive jokapitale është 114,186€, si dhe e stoqeve 658€.

#### Çështja A6 - Mos invenatrizim i regjistrave të pasurive

- Gjetja** Sipas Rregullores MF - nr. 02/2013 - Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 18, inventarizimi duhet të kryhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Tutje, neni 19, përcakton se Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare do të jetë organ i përkohshëm i formuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ i organizatës buxhetore.
- ZRRE nuk kishte themeluar komisionin e inventarizimit, rrjedhimisht nuk kishte zhvilluar procesin e inventarizimit të pasurive për vitin 2025. Kjo ka pamundësuar verifikimin e gjendjes fizike të pasurive dhe krahasimin e tyre me gjendjen në regjistrat kontabël.
- Kjo situatë është rezultat i mungesës së vëmendjes dhe koordinimit të mjaftueshëm nga personat përgjegjës për caktimin e komisionit dhe realizimin e procesit të inventarizimit.
- Ndikimi** Mos kryerja e inventarizimit vjetor pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë. Kjo dobëson sistemin e kontrollit të brendshëm dhe rrit rrezikun e humbjes, dëmtimit ose keqpërdorimit të pasurisë publike.
- Rekomandimi A6** Kryetari i Bordit të ZRRE-së duhet të sigurojë se është caktuar komisioni i inventarizimit të pasurive i cili do të kryej inventarizimin e plotë vjetor të pasurisë në përputhje me kërkesat ligjore, të bëjë harmonizimin e gjendjes faktike me regjistrat kontabël në mënyrë që ndryshimet e nevojshme të reflektohen në regjistrin e pasurive.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

ZRRE nuk ka të themeluar Njësine e Auditimit të Brendshëm (NjAB). Kjo për arsye se konsiderohet agjenci e vogël dhe nuk plotëson kriteret ligjore për themelimin e një njësie të veçantë të auditimit të brendshëm.

#### Çështja A7 - Mungesa e zbatimit të funksionit të auditimit të brendshëm

**Gjetja** Sipas Rregullore QRK-NR 01/2019 për Themelimin dhe Zbatimin e funksionit të Auditimit të Brendshëm në subjektin e Sektorit Publik, neni 5, paragrafi 2, subjekti i sektorit publik i cili ka buxhet më pak se tre (3,000,000€) milionë euro, funksionin e auditimit të brendshëm ta ushtron përmes mënyrave tjera sipas nën paragrafëve 1.2, 1.3. dhe 1.4 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje, respektivisht, subjektet e sektorit publik janë të obliguara të sigurojnë funksionin e auditimit të brendshëm përmes njërës nga format e përcaktuara: njësi e përbashkët e auditimit të brendshëm, marrëveshje për sigurimin e shërbimit të auditimit nga një subjekt i sektorit publik, apo kontraktim i një kompanie me miratim paraprak të Ministrit të Financave.

ZRRE nuk ka siguruar zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm. Rrjedhimisht, nuk ka patur një monitorim të pavarur të sistemeve të kontrollit të brendshëm që nga viti 2021 dhe as ndonjë kërkesë tjetër për mbulimin e këtij funksioni.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së veprimeve konkrete nga ZRRE për të siguruar një zgjidhje në lidhje me ushtrimin e funksionit të auditimit të brendshëm përmes alternativave të parashikuara ligjore.

**Ndikimi** Mosrealizimi i auditimit të brendshëm rrit rrezikun e moszbulimit të dobësive në sistemin e kontrollit të brendshëm, menaxhimit financiar, ruajtjes së pasurisë publike dhe zbatimit të ligjeve.

**Rekomandimi A7** Kryesuesi i Bordit të sigurojë funksionin e auditimit të brendshëm duke aplikuar njërën nga format e lejuara ligjore, në mënyrë që të garantohet funksionimi efektiv i këtij funksioni dhe forcimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>6</sup>	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>1,148,610</b>	<b>932,756</b>	<b>827,786</b>	<b>739,156</b>	<b>680,982</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	1,148,610	932,756	827,786	739,156	680,982

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 215,854€. Ky zvogëlim është rezultat i Vendimit të Qeverisë për kursime buxhetore.

Në vitin 2025, ZRRE ka shpenzuar 89% të buxhetit përfundimtar, krahasuar me vitin paraprak kur realizimi i buxhetit ishte 93%. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>1,148,610</b>	<b>932,756</b>	<b>827,786</b>	<b>739,156</b>	<b>680,982</b>
Pagat dhe mëditjet	567,478	387,597	387,597	381,131	374,511
Mallrat dhe shërbimet	478,332	442,359	340,263	291,070	224,972
Komunalitë	22,000	22,000	19,498	21,702	10,687
Investimet Kapitale	80,800	80,800	80,428	45,253	70,812

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


Buxheti final në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje, krahasuar me buxhetin fillestar, është zvogëluar për 179,881€ si rezultat i Vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore, si dhe lëvizjet buxhetore për shkak të rritjes së njësisë së koeficientit për 0,5. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 100%.

Buxheti final në kategorinë mallra dhe shërbime, krahasuar me buxhetin fillestar, është zvogëluar për 35,973€ sipas Vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 77%.

Buxheti final për shpenzime komunale, krahasuar me buxhetin fillestar, ka mbetur i pandryshuar. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 89%.

Buxheti final për investime kapitale, krahasuar me buxhetin fillestar, ka mbetur i pandryshuar. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 99%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) gjatë vitit 2025 ishin në vlerë prej 1,900,602€. Këto të hyra kryesisht rrjedhin nga tarifat për licencim dhe nga gjambat e shqiptuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>1,000,000</b>	<b>1,000,000</b>	<b>1,900,602</b>	<b>6,055,738</b>	<b>7,638,992</b>
Të hyrat jo tatimore	1,000,000	1,000,000	1,900,602	6,055,738	7,638,992

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2024 të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) kishte rezultuar me një rekomandim. ZRRE kishte përgatitur një plan veprimi, në të cilin ishte paraqitur mënyra e zbatimit të rekomandimit të dhënë.

Deri në përfundim të auditimit tonë për vitin 2025, rekomandimi është zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari i Bordit të ZRRE-së duhet të sigurohet që, zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjeve bëhet para se të pranohen mallrat dhe faturat, në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohet rritja e detyrimeve të pa paguara.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur në raste të ngjashme të vonesave në vitin aktual.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit




Besim Lezi, Udhëheqës i ekipit



Besarta Rrahmani, Anëtare e ekipit



Arbresha Grainca, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- **pajtohem** me gjetjet dhe rekomandimet në draft Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Rregullatorit të Energji për vitin 2025 për të gjeturat: **A1, A5 dhe A6. Pajtohem pjesërisht** me Gjetjen **A4**, ndërsa **nuk pajtohem** me gjetjet: **A2, A3, dhe A7**.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Ymer Fejzullahu  
Kryesues i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energji

Apër:   
Data: 13.05.2026



Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mangësi në mbajtjen e regjistrave të pasurisë	<p>Zyra e Rregullatorit për Energji si institucion i pavarur është e përkushtuar për respektimin e plotë të dispozitave ligjore në fuqi, përfshirë këtu edhe Rregulloren MF-Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar dhe Rregulloren MF-Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare.</p> <p>Sa i përket çështjeve të ngritura:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mos regjistrimi me kohë i pasurisë kapitale (veturës dhe pajisjeve të TI-së) në SIMFK ka ndodhur si pasojë e vonesave në procesimin dhe verifikimin e të dhënave në sistem, si dhe për shkak të mbingarkesës me punë të stafit përgjegjës në periudhën e përgatitjes së pasqyrave financiare.</li> <li>- Në rastin e pasurive nën 1,000€, regjistrimi i tyre në e-Pasuria me datë të vonuar (nëntor 2025) dhe aplikimi jo i plotë i zhvlerësimit ka ardhur si rezultat i mungesës së përditësimit në kohë të të dhënave dhe kufizimeve në njohuritë praktike për përdorimin e sistemit, si dhe mungesës së trajnimeve adekuata për stafin përgjegjës.</li> <li>- Gjithashtu, duhet theksuar se kapacitetet aktuale të stafit në Njësinë përkatëse janë të kufizuara, duke marrë parasysh vëllimin e shtuar të punëve dhe numrin e reduktuar të zyrtarëve, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në efikasitetin e përditësimit të regjistrave.</li> </ul> <p>Pavarësisht këtyre sfidave, ZRRE ka ndërmarrë në</p>	Entiteti është pajtuar me gjetjen dhe ka dhënë arsyet për çështjen A1. Ndërsa entiteti ka dhënë sqarime lidhur me veprimet që do të ndërmarrë për adresimin e çështjes.

	<p>vazhdimësi masa konkrete për adresimin e këtyre çështjeve:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Është bërë verifikimi i plotë dhe harmonizimi i të gjitha pasurive ndërmjet SIMFK, e-Pasuria dhe regjistrave kontabël;</li> <li>2. Janë bërë disa regjistrime me kohë, mirëpo në mungesë të stafit dhe të trajnimeve me kohë, nuk kemi arritur t'i regjistrojmë të gjitha pasuritë në momentin e pranimit të tyre, megjithatë do të përmirësohet kontrolli i brendshëm përmes rishikimit të procedurave dhe vendosjes së mekanizmave shtesë të verifikimit para përgatitjes së pasqyrave financiare</li> <li>3. ZRRE në vazhdimësi ka kërkuar nga Ministria përkatëse që OE i cili ka krijuar sistemin e-Pasuria të organizoj trajnime shtesë për stafin lidhur me përdorimin e sistemeve SIMFK dhe e-Pasuria, mirëpo kemi hasur në vonesa nga ta. Për shkak të kapaciteteve njerëzore në këtë fushë, Zyra e Rregullatorit për Energji ka ngecur në këtë aspekt, por me shqyrtimin e Strukturës Organizative shpresojmë që të evitohen këto ngecje dhe t'i shmangim situatat e ngjashme në të ardhmen.</li> </ol>	
<p>Mungesa e veprimeve të mjaftueshme për realizimin e arkëtimit të gjobës</p>	<p>ZRRE ka sqaruar se pas marrjes së vendimit nr. V_1618_2022 dhe vendimeve tjera për gjoba, ZRRE ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për arkëtimin e gjobave. Gjithashtu ka sqaruar se Vendimi i Bordit të ZRRE nr. V_1618_2022 është në proces</p>	<p>Veprimet e shpalosura në komentin e entitetit kanë të bëjnë me padinë e paraqitur nga KESCO për anulimin e vendimit të ZRRE-së lidhur me gjobën, nr. V_1618_2022. Megjithatë, gjetja e auditimit ndërlidhet me mungesën e ndërmarrjes me kohë të</p>

	<p>gjyqësor për çështjen meritore, dhe më poshtë janë të përmbledhura veprimet e ZRRE për këtë çështje:</p> <p>1. Me datë 25.02.2025, ZRRE ka pranuar nga Gjykata Komerciale aktin KA.nr. 1526/22, përmes të cilit është kërkuar paraqitja e përgjigjes në padi lidhur me çështjen e meritave që ndërlihet me Vendimin nr. V_1618_2022.</p> <p>2. Me datë 20.03.2026, ZRRE ka dorëzuar përgjigjen në padi, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e paditësit dhe duke propozuar që gjykata, në shqyrtimin e meritave, ta refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar.</p> <p>3. Me datë 07.07.2025, Gjykata ka dorëzuar ftesën për shqyrtim kryesor, i cili ishte planifikuar të mbahej më 23.07.2025.</p> <p>4. Në ditën e shqyrtimit, gjykata, në prezencë të palëve, ka kërkuar shtyrjen e seancës për një datë tjetër, me arsyetimin se i nevojitet kohë shtesë për analizimin më të detajuar të rastit, duke pasur parasysh edhe praktikën gjyqësore në raste të natyrës së njëjtë (përfshirë rastet ndaj KOSTT), ku gjykatat e rregullta kanë refuzuar paditë dhe kanë vërtetuar vendimmarrjen e ZRRE-së për shqyrtimin e gjobave.</p> <p>5. Që nga ajo datë, ZRRE nuk ka pranuar ndonjë ftesë tjetër</p>	<p>veprimeve nga ana e ZRRE-së siç janë të përcaktuara me legjislacionin për ekzekutimin e vendimit të saj, edhe pas skadimit të afatit të përcaktuar për pagesë. Gjatë shqyrtimit të rastit, ZKA, ka marrë në konsideratë sqarimet dhe dokumentacionin e ofruar nga ZRRE lidhur me zhvillimet gjyqësore të rastit të gjobës ndaj KESCO-s. Shqyrtimi i çështjes në mënyrë meritore në procedurën gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e aktit administrativ pasi në këtë rast padia nuk ka efekt pezullues. Prandaj, komenti i ZRRE-së ofron sqarime të cilat nuk e ndryshojnë gjetjen e auditimit.</p>
--	--	---

	<p>për seancë apo njoftim të ri procedural nga Gjykata.</p> <p>6. Rasti aktualisht ndodhet në fazën e shqyrtimit gjyqësor MERITOR në Gjykatën Komerciale, në pritje të caktimit të një seance të re për shqyrtim kryesor.</p>	
Dobësi në pagesën e shërbimeve për ngrohje/ftohje	<p>Zyra e Rregullatorit për Energji ka siguruar shërbimet e ngrohjes dhe ftohjes përmes një operatori ekonomik të jashtëm, përmes një sistemi të bazuar në pompa termike, i cili ofron furnizim të integruar për të dy sezonet (dimëror dhe veror). Ky sistem, nga natyra e tij teknike, operon si një njësi e centralizuar, ku konsumi energjetik dhe shpërndarja e kostos nuk mund të ndahen lehtësisht në mënyrë individuale për çdo njësi përfituese pa pajisje specifike matëse.</p> <p>Në këtë kontekst, për mungesë të matësve individualë dhe në përputhje me praktikën e zakonshme të menaxhimit të objekteve me sisteme të centralizuara, është aplikuar një tarifë fikse mujore për m<sup>2</sup> për të gjithë konsumatorët të cilët gjenden në këtë ndërtesë. Kjo qasje përfaqëson një metodë të shpërndarjes proporcionale të kostos bazuar në m<sup>2</sup> të secilit konsumatorit, e cila përdoret gjerësisht në raste të ngjashme kur matja direkte e konsumit nuk është e realizueshme. Gjithashtu duhet theksuar se kjo tarifë fikse për m<sup>2</sup> e përdorur është pothuajse se tarifa e përdorur nga NQ "Termokos" për konsumatorët</p>	<p>Gjetja e auditimit nuk ndërlidhet me nevojën apo mënyrën operative të ofrimit të shërbimit, por mungesën e dokumentacionit mbështetës dhe bazës së kalkulimit të çmimit të faturuar.</p> <p>Nga auditimi është konstatuar se marrëveshja nuk përcakton çmimin e shërbimit dhe nuk janë ofruar dëshmi mbështetëse që do të mundësonin verifikimin e çmimit të faturuar.</p> <p>Komenti nuk është shoqëruar me dëshmi të reja mbështetëse, andaj gjetja dhe rekomandimi mbesin të pandryshuara.</p> <p>Për më tepër, ZRRE, në marrëveshjen e re për vitin 2026 ka përfshirë elementet e çmimit të këtij shërbimi, me ç'rast edhe është pranuar konstatimi i auditimit se marrëveshja ekzistuese kishte mangësi në dokumentimin e bazës së faturimit.</p>

	<p>e konsumatorëve institucione. Gjithashtu duhet theksuar se ky shërbim nuk është vetëm për ngrohje dhe se është edhe për ftohje. Për këtë arsye, aplikimi i një tarife fikse gjatë gjithë vitit ka synuar të reflektojë koston reale të një shërbimi publik të integruar dhe të vazhdueshëm.</p> <p>Po ashtu, theksojmë se marrëveshja është realizuar në funksion të sigurimit të vazhdimësisë së shërbimit dhe shmangies së ndërprerjeve operative, në një situatë ku mungon një metodologji e standardizuar për ndarjen e kostos për sisteme të këtij lloji në nivel institucional, ZRRE e ka të pamundur të përdor mekanizma tjerë të kalkulimit përveç asaj të tarife fikse për m<sup>2</sup>.</p> <p>Megjithatë, duke marrë parasysh vërejtjet e auditimit, Zyra e Rregullatorit për Energji ka reflektuar dhe ka ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e mëtejshëm të kësaj fushe. Në kontratën e re nga gushti i vitit 2026, parashihet të përfshihen elemente më të qarta lidhur me sistemin e ngrohje/ftohjeve, në mënyrë që sistemi të jetë i ndarë enkas vetëm për ZRRE –në, duke përfshirë njësorë të veçantë për mënyrën e kalkulimit për ngrohje dhe ftohje.</p> <p>Pavarësisht hapave që ZRRE do t'i ndërmarrë, përsëri mbetet e përkushtuar për të avancuar më tej transparencën dhe përputhshmërinë me kërkesat rregullative, duke ruajtur</p>	
--	---	--

Zyra Kombëtare e Auditimit - Nacionalna Kancelarija Revizije - National Audit Office  
 Prishtinë, Kosovë | Të gjitha të drejtat rezervohen | Kontakt: +383 45 211 100 | www.audit.gov.mk

	njëkohësisht funksionalitetin dhe efikasitetin operacional të institucionit.	
Mosazhurnimi i rregulloreve të brendshme dhe kontratave të punës në përputhje me ndryshimet ligjore	<p>Procesi i harmonizimit të akteve të brendshme me legjislacionin e ri nuk ka qenë një proces formal apo i thjeshtë administrativ, por një proces kompleks që lidhet drejtpërdrejt me statusin dhe funksionimin e institucioneve të pavarura.</p> <p>Në këtë drejtim, implementimi i kërkesave që rrjedhin nga Ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura kushtetuese, si dhe nga Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë dhe Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, është ndikuar nga disa faktorë objektivë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>· Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të cilat kanë trajtuar disa çështje thelbësore lidhur me pavarësinë funksionale dhe organizative të institucioneve të pavarura, duke kërkuar një qasje të kujdeshme dhe të analizuar në zbatimin e legjislacionit përkatës;</li> <li>· Ka ekzistuar dhe vazhdon të ekzistojë nevoja për harmonizim të qëndrimeve ndërinstucionale, e në rastin tonë ndërmjet ZRRE-së dhe Departamentit për Menaxhimin e Zyrarëve Publikë, lidhur me interpretimin dhe zbatimin praktik të dispozitave ligjore;</li> <li>· Për të shmangur zgjidhje të pjesshme ose të paqëndrueshme, ZRRE ka vlerësuar të domosdoshme që</li> </ul>	ZKA ka shqyrtuar komentet e dhëna nga ZRRE. Megjithatë, duke qenë se komentet nuk janë shoqëruar me dëshmi që do të dokumentonin gjendjen ndryshe, gjetja mbetet e pandryshuar. Sa i përket veprimeve të iniciuara, ato do të monitorohen në proceset e ardhshme të auditimit.

	<p>procesi i azhurnimit të lidhet fillimisht me riorganizimin e plotë të Strukturës Organizative, e cila aktualisht është në shqyrtim.</p> <p>Në këtë kontekst, mungesa e përditësimit të menjëhershëm të rregulloreve dhe kontratave nuk ka qenë rezultat i mosveprimit, por pasojë e një procesi të kujdesshëm vlerësimi dhe koordinimi institucional.</p> <p>Për më tepër, duhet potencuar se Ligji për Zyrarët Publik i është nënshtruar vlerësimi të kushtetutshmerisë nga Gjykata Kushtetuese, dhe se edhe Zyra e Rregullatorit për Energji duke parë se po i cenohej edhe pavarësia institucionale, ka dërguar komente në Gjykatën Kushtetuese për të kërkuar ruajtjen e pavarësisë institucionale. Siç edhe jeni në dijeni, Gjykata Kushtetuese ka nxjerr Aktgjykimin e saj me datë 28 Prill 2025, dhe se pas Aktgjykimit, Ligji për Zyrarët Publik i është nënshtruar edhe njëherë plotësim ndryshimit.</p> <p>Ligji për Zyrarët Publik i ndryshuar dhe i plotësuar është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës me datë 2 Qershor 2025. Lidhur me këtë, ZRRE ka qenë në pritje të këtyre veprimeve gjyqësore e institucionale. Gjithashtu duhet theksuar se nga Ligji bazë i Zyrarëve Publik e më pas edhe i ndryshuar dhe i plotësuar ka përjashtuar edhe disa institucione tjera të cilat nuk kanë qenë fillimisht pjesë e Ligjit bazë, dhe se ekziston edhe një dispozitë ligjore në Ligjin Nr. 08/L - 294 për</p>	
--	---	--

	<p>ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/l- 197 për Zyratet Publik, përkatësisht neni 4, paragrafi 3, ku ZRRE pretendon se ka ligjin e saj specifik (Ligji për Rregullatorin e Energjisë) i cili ligj e specifikon se ZRRE nuk e ka statusin e shërbyesit civil, dhe se nuk do të duhej t'i nënshtrohej Ligjit për Zyratet Publik, mirëpo edhe për këtë kemi hasur në mospajtim me DMZP. Bazuar në këtë pas këtyre veprimeve gjyqësore dhe institucionale, si dhe mospajtime me DMZP, janë shfaqur edhe vonesa në hartimin e Rregulloreve të brendshme me të vetmin qëllim se ZRRE vlerëson se ajo cenon pavarësinë institucionale. Megjithatë ZRRE duke mos pasur tjetër zgjidhje ka filluar plotësim ndryshimin e Rregulloreve të brendshme, si ajo e për klasifikimin e vendeve të punës dhe ajo për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.</p> <p>Aktualisht institucioni është në fazën e konsultimeve dhe sigurimit të mbështetjes profesionale nga organizata ndërkombëtare relevante, me qëllim që rregullorja të reflektojë standardet më të mira të qeverisjes institucionale dhe kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi. Në lidhje me Rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës, kjo rregullore është e ndërlidhur ngushtë me rregulloren e organizimit të brendshëm dhe sistematizimit, pasi klasifikimi bazohet në strukturën</p>	
--	---	--

	<p>organizative, përshkrimet e detyrave dhe nivelizimin e pozitave të përcaktuara në të. Për këtë arsye, hartimi dhe miratimi i saj do të procedohet menjëherë pas finalizimit të rregullores së organizimit të brendshëm, në mënyrë që të sigurohet koherencë normative dhe zbatim praktik i qëndrueshëm.</p> <p>Gjithashtu, sa i përket rasteve të identifikuara të mospërputhjeve në klasifikim dhe ekuivalencë, theksojmë se këto janë çështje që lidhen me tranzicionin ndërmjet dy sistemeve të rekrutimit dhe janë duke u trajtuar në kuadër të procesit të përgjithshëm të harmonizimit.</p> <p>ZRRE mbetet e përkushtuar që pas finalizimit të Strukturës Organizative dhe sigurimit të qartësisë së plotë në interpretimin e legjislacionit, të procedojë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>· miratimin e rregullores së përditësuar të brendshme;</li> <li>· harmonizimin e plotë të klasifikimit të pozitave;</li> <li>· dhe përditësimin e kontratave individuale të punës në përputhje me kërkesat ligjore.</li> </ul> <p>ZRRE poashtu vlerëson se edhe finalizimi i strukturës organizative në mënyrën si kërkohet me ligji nr. 06/l -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura është në kundërsthim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, pasi organizimi i strukturës organizative duhet të</p>	
--	--	--

Dokumenti i kësaj lloji është i hapur dhe i aksesueshëm për publikun dhe nuk është i ndaluar nga ligji për mbrojtjen e informacionit të ndaluar.

	<p>jetë si ajo e Ministrive dhe se për miratimin e saj kërkohet mendim këshillimor nga organet e Qeverise (ministrit përgjegjës për administratën publike, ministrit përgjegjës për financa) dhe Auditori i Përgjithshëm (neni 42, paragrafi 4). Pra sipas kësaj një institucion i pavarur duhet të marr mendim këshillimor nga Qeveria dhe një institucion tjetër i pavarur, sikur këto institucione e dijnë më mirë funksionimin e një institucioni tjetër të pavarur. Ndërsa neni 9, paragrafi 3 dhe 4, i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë e qartëson qartë se: “3. Bordi përgatit dhe miraton rregullat që administrojnë aktivitetin e Rregullatorit, përfshirë strukturën e zyrës, procedurat për punësimin e personelit, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me organizimin e punës. 4. Rregullat gjithashtu mund të përcaktojnë procedurat për punësimin e personelit në bazë të kontratave për një periudhë kohore të përcaktuar me Ligjin e Punës në Kosovë.”</p> <p>Pra nuk është se ZRRE nuk ka ndërmarrë veprime konkrete lidhur me azhurnimin e rregulloreve të brendshme dhe kontratave të punës, por që për shkak të Aktgjytimeve të Gjykatës Kushtetuese lidhur me Ligjin për Zyrtaret Publik dhe plotësim ndryshimin e saj, si dhe mospajtimeve të theksuara me DMZP keto rregullore kanë pësuar pak vonesë.</p>	
--	--	--

<p>Mos përdorimi i modulit në sistemin e prokurimit elektronik për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve</p>	<p>Stafi përkatës në kuadër të Administratës ka ndjekur trajnime lidhur me përdorimin e sistemit të prokurimit elektronik, përfshirë menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës. Këto trajnime janë realizuar pas caktimit të menaxherëve të kontratave të mëhershme, çka ka ndikuar në aplikimin gradual të kërkesave të rregullores.</p> <p>Gjithashtu, duhet theksuar se gjatë vitit 2025, ZRRE ka pasur disa kontrata në përfundim e sipër, rrjedhimisht nuk ka pasur mundësi praktike për aplikimin e plotë të modulit për menaxhimin dhe vlerësimin e kontratave në sistemin e prokurimit elektronik, meqenëse trajnimi ka përfunduar në fund të vitit të kaluar.</p> <p>Pavarësisht kësaj, ZRRE ka ndërmarrë hapa konkretë për përmirësimin e kësaj çështjeje, ku në kuadër të diskutimeve të brendshme Njësia e Administratës ka për qëllim që për këtë çështje të ndërmarrë hapat konkret si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të gjitha proceset e menaxhimit të kontratave të realizohen në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rekomandimet tuaja;</li> <li>• të përdoret në mënyrë obligative moduli i prokurimit elektronik për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve;</li> </ul>	<p>Entiteti është pajtuar me gjetjen dhe ka dhënë arsyet për çështjen A6. Ndërsa entiteti ka dhënë sqarime lidhur me veprimet që do të ndërmarrë për adresimin e çështjes.</p>
---	--	--

	<ul style="list-style-type: none"> <li>të forcohet përgjegjësia e menaxherëve të kontratave në përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore;</li> <li>të vazhdohet bashkëpunimi dhe koordinimi me KRPP për sigurimin e zbatimit korrekt të këtyre procedurave.</li> </ul>	
<p>Mungesa e zbatimit të funksionit të auditimit të brendshëm/marrveshjes për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm</p>	<p>Lidhur me këtë gjetje, ju informojmë se Zyra e Rregullatorit për Energji në vitet paraprake ka bërë përpjekje që të sigurojë këtë shërbim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke i kërkuar Sekretarit të Kuvendit sigurimin e këtyre shërbimeve meqenëse ZRRE si agjenci e pavarur i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit. Përgjigja që kemi marrë nga Sekretari i Kuvendit ka qenë se nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për sigurimin e këtyre shërbimeve edhe për ZRRE-në (vet Kuvendi atë kohë kishte vetëm një auditor të brendshëm).</p> <p>Përveç kësaj, viteve të fundit nga ZKA nuk është që kemi marrë ndonjë rekomandim lidhur me këtë çështje, meqenëse auditorët kanë qenë të njoftuar me përpjekjet e ZRRE-së dhe vështirësitë që kemi hasur në sigurimin e këtyre shërbimeve.</p>	<p>Pavarësisht faktit se ZRRE konsiderohet institucion me buxhet nën pragun për themelimin e njësisë së veçantë të auditimit të brendshëm, rregullorja obligon institucionin që funksionin e auditimit të brendshëm ta sigurojë përmes njërës nga format alternative të përcaktuara ligjore.</p> <p>Meqenëse gjatë periudhës së auditimit, por as me komente, nuk janë ofruar dëshmi për ndonjë marrëveshje apo mekanizëm funksional për ushtrimin e auditimit të brendshëm, gjetja dhe rekomandimi mbesin të pandryshuara.</p>

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>7</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>8</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Këto raste kanë të bëjnë me: “Furnizim dhe mirëmbajtje me pajisje të TI-Ueb, Certifikata dhe Server Cloud për nevojat e ZRRE”, “Furnizim me internet sekondar për ZRRE” dhe “Furnizim me server storage dhe firewall”.
- <sup>6</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>7</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>8</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.